



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 740 Prot.

Tiranë, më datë 24.07.2020

**VENDIM**

**Nr. 230, datë 24.07.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.07.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Shtesë kapaciteti të depozitave të naftës”, Porto Romano, Durrës, me zhvillues “KASTRATI” sh.a., dhe raport të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor të realizuar nga personi i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Subjekti duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Shtesë kapaciteti të depozitave të naftës” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

**KRYETAR**

Elva MARGARITI

